

RENDI I DITËS

Projektakti "Shqyrtimi i kërkesës Ankimore nr. 03 me objekt: "Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.46, datë 09.02.2021" me ankues, subjekti z. Erion Veliaj".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, A.Llano
- **Parti Politike:** PS, LSI

Z.K.Bele: Përshëndetje! Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore regjistruar me numër 3, datë 11.02.2021, të subjektit ankues Erion Veliaj, i përfaqësuar nga avokati Eridjan Salianji, me objekt ndryshimin e vendimit nr.46, datë 09.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe pika 2, rrëzimin e ankimit të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim për dënimin administrativ të kryetarit Erion Veliaj. Verifikojmë palët prezente, për ankuesin?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Avokat Eridjan Salianji,

Z.K.Bele: Palë të tjera?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim: Palë e interesuar, Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuar nga Altin Kaziaj dhe Kreshnik Kolndreu.

Z.K.Bebe: Janë depozituar aktet përkatëse të përfaqësimit?

Z.E.Salianji, përfaqësues i Partisë Socialiste: Përsa i përket përfaqësimit është një prokurë në dosje por po paraqes edhe një prokurë ta ketë administrata.

Z.K.Bebe: Eshtë në dosjen e shqyrtimit administrativ?

Z.E.Salianji, përfaqësues i Partisë Socialiste: Po, megjithatë merreni.

Z.K.Bebe: Dakord! Kemi, në këtë fazë të procedimit kemi ndonjë kërkesë paraprake nga palët? Nuk kemi! A kemi ndonjë palë tjetër apo person që ka paraqitur kërkesë për tu legjitimuar në këtë proces?

Z.Y.Merkaj: Jo nuk kemi.

Z.K.Bebe: Faleminderit! Do relatohet vendimi nga ana juaj?

Z.Y.Merkaj: E relatuam njëherë ne, herën e parë.

Z.K.Bebe: Dakord! Ftojme palët të paraqesin pretendimet.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Faleminderit. Siç dhe jeni njohur me ankimin kundra vendimit të Komisionerit, ne i qëndrojmë ankimit dhe shkaqeve të paraqitura në të, i kemi me shkrim 8 faqe i depozitojmë dhe shkurtimisht ju jeni njohur me ankimin, mos lexojmë në mënyrë narrative ankimet dhe parashtrimet, do thoja që siç është edhe e shkruar në vendim, aty parashikohen 2 gjoba, është vendosur gjobë për veprimtari të ndaluara dhe gjobë për mos raportim. Së pari unë do të paraqisja që Bashkia e Tiranës e ka nisur që të raportojë aktivitetet e kryetarit të Bashkisë, menjëherë me krijimin e të dhënave në faqen e krijuar nga KQZ-ja. Aktivitetet e zhvilluara nuk kanë qenë të hapura për publikun apo nuk kanë patur agjentë informimi, por kanë qenë pjesë e vazhdimësisë së procesit të rindërtimit të nisur që në fillim të vitit 2020. Së pari për të qenë subjekt i ligjit dhe që të dënohesh, së pari duhet të kryesh një veprimtari të ndaluar dhe ose të ndaluar dhe kjo veprimtari të jetë publike, pra të dyja bashkë. Së pari unë do të parashtroja se veprimtaritë për të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi nga Komisioneri nuk janë të ndaluara, pse nuk janë të ndaluara? Nuk janë të ndaluara sepse në kuptim të vendimit nr.9 datë 04.12.2020, veprimtari të ndaluara janë ato veprimtari të cilat plani buxhetor parashikohet para kësaj date, plani buxhetor për të bërë aktivitetet, për të ndërtuar, për të rikonstruktuar, etj. Unë do të thoja që ne kemi provuar para Komisionerit që objektet të cilat janë inspektuar nga kryetari i Bashkisë, kanë qenë objekte të cilat janë buxhetuar në vitin 2020, sepse janë objekte përsa i përket rindërtimit dhe të tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe këto kanë qenë në kuadër të inspektimit të një buxheti të parashikuar shumë kohë më përpara.

Z.K.Bebe: Avokat më fal për racionalitet, nuk jemi përpara ankimit për veprimtari të ndaluara, kemi një vendim të Komisionerit,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.16.02.2021

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Dhe tani do kaloj ke njoftimi, së pari. Së dyti për sa i përket pjesës publike siç e kemi sqaruar dhe në ankim dhe gjatë shqyrtimit nga Komisioneri parashtruar që këto veprimtari nuk janë publike, pse nuk janë publike, këto nuk janë kryer në kuptim të ligjit që veprimtari publike do të thotë pjesëmarrja e medias në mënyrë të hapur, etj. Veprimtaria e kryer nga kryetari i Bashkisë, e cila është hedhur në facebook e tij personal dhe më pas mediat e kanë transmetuar nuk e bën këtë veprimtari publike, për arsye se facebooku është karakter personal dhe nuk ka lidhje me mënyrën sesi transmetohet veprimtaria publike. Këtë standard e keni mbajtur edhe ju si institucion në një vendim të mëparshëm dhe besoj dhe kjo pikë është ezauruar që nuk është një veprimtari publike. Në arsyetim të vendimit, thelbi i vendimit thuhet që, Kryetari i Bashkisë dënohet me gjobë për shkak se ka shpërndarë dokumenta pronësie. Ky pretendim i Krye Komisionerit është i pabazuar sepse së pari, logjikisht të gjithë objektet e inspektuara janë objekte të cilat sapo ka përfunduar procesi i rindërtimit. Vetë procesi teknik ligjor, nuk ka bërë që të dali një çertifikatë pronësie, ose një dokument tjetër pronësie që kryetari i bashkisë të ketë mundësi ta japi, pra vetë logjikisht dhe ligjërisht nuk mund të ndodhi si proces teknik, por unë provoj përpara jush që proces verbale të cilët quhen nga Komisioneri dokumenta pronësie ose të përmenden, mund edhe të jenë të përmendur në lapsus nga kryetari i Bashkisë, janë dokumenta proces verbalë për dorëzimin e objektit dhe këto proces verbale unë i paraqes përpara jush, i kam paraqitur dhe si provë në ankim që për të gjithë shtëpitë të cilat presupozohet që janë shpërndarë dokumenta pronësie, nuk janë dokumenta pronësie, ligji për kadastrën e ka përcaktuar qartë cilat janë dokumentat e pronësisë, janë hartat treguese, kartelat, çertifikatat e pronësisë, ne nuk jemi përballë këtij rasti, në shtëpitë e inspektuara për familjarë që nuk dua ti përmend emrin, janë depozituar proces verbalë paraprakë për marrjen në dorëzim

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

të objektit, pra aty është normalisht është kryer puna, do merret në dorëzim objekti, pastaj fillon një proces ligjor dhe thjesht inspektim rutin pune dhe ky lloj proces verbali është përse i përket inspektimit dhe jo dokumentave të pronësisë. Vendimi numër 9 datë 24.12.2020, është parashikuar qartë fare se çfarë janë dokumentat e pronësisë, thuhet mos shpërnda leje legalizimi, mos shpërnda dokumente pronësie, por në asnjë rast nuk ndalohej që ti të inspektosh dhe aty për të marrë një objekt në dorëzim të japësh një proces verbal dorëzimi, et etj, pra nuk jemi përballë këtij fakti dhe këtë ju paraqes si provë, rreth 5 proces verbale siç i keni dhe në dosje. Pra për sa më sipër thashë, jua provova të treja, nuk është veprimtari e ndaluar, për arsye se është plani buxhetor dhe këtë e keni dhe bashkëngjitur buxhetet e 2020, që e kemi sjellë si provë, e dyta nuk është veprimtari publike se është një punë rutinë e kryetarit të bashkisë, pavarësisht e hedhur në facebook, nuk e bën veprimtari me karakter publik dhe së treti nuk janë dokumente pronësie, në të cilën siç e citon Krye Komisioneri. Pavarësisht se këtë shprehje mund ta ketë marrë edhe nga relacioni që ka bërë në bashkinë e Tiranës që ka ardhur nga zyra e medias i ka çuar një shkresë, dhe ata kanë sjellë një relacion, por nuk e bën relacioni provën, Krye Komisioneri për ta provuar këtë minimumi duhet të kishte kërkuar se cilat janë dokumentat, meqenëse ndodhemi përballë faktit, gjoha u ndodh, ne atëherë po e sjellim ne provën. Përse i përket gjobës së dytë, që ka të bëjë më mos raportim, kjo për mua nuk ha diskutim, pra vetëm kjo nuk duhet të ishte diskutuar, nëqoftëse karakteri publik dhe ke bërë veprimtari apo skë bërë dhe mund të hante diskutim, kjo nuk diskutohet, për arsye se ligjvënësi e ka përcaktuar shumë qartë se cilat janë subjektet të cilat raportojnë dhe në nenin 10 thuhet që subjektet janë sekretarët e përgjithshëm, drejtorët e përgjithshëm, nuk mundet që të dënosh kryetarin e bashkisë edhe sikur stafi nuk e ka kryer raportimin, pavarësisht se ne themi që edhe mos raportimin kemi të provuar edhe shkaqet pse ka ndodhur ky mos raportim, por

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021**

ligjërisht subjekti Erion Veliaj, nuk është përgjegjës, se këtu po gjykojmë së pari, po gjykojmë vendimin e Komisionerit si dhe të drejtën që ka çdo subjekt i cili kallëzohet. Subjekti të cilit i është kallëzuar nuk është përgjegjës për të kryer këtë veprimtari. Se cili është personi përgjegjës këtë duhej ta hetonte Komisioneri ose duhet ta kallëzonte në rastin më të mirë kallëzuesi dhe këtu jemi që ti vesh, një polici rrugor ti vejë gjobë nëqoftëse një punonjësi, një makine e bashkisë shkel semaforin me të kuq dhe gjoba ti shkojë kryetarit të bashkisë, pra aq e ndarë është në vetë vendimin numër 9 të 2020, subjekte të cilat kanë të drejtën dhe detyrimin të raportojnë. Tani janë faktet që në datë 29 dhjetor dhe këtë po e bëj edhe nëqoftëse, në datë 29 dhjetor i ka vajtur shkresa Bashkisë së Tiranës dhe nga ky moment Bashkia e Tiranës detyrohet që të bëjë raportimin. Në 29 dhjetor dhe në vetë vendimin thuhet që 5 ditë, ti ke detyrimin që veprimtaritë e tua ti deklarojsh të paktën 5 ditë. Pra ti merr një vendim sot dhe momenti të cilën vetë vendimi ty të ve detyrimin që të raportosh është 5 ditë, pra ti duhet të raportojë veprime të cilat nuk kishte hyrë rregullorja në fuqi, ose veprimet e kryera në datë 29,30,31,1,2,3 duhet ti raportojë në datë 29, pra në moment që ka hyrë rregullorja në fuqi. Ka një korrespondencë në Bashkinë e Tiranës në të cilën në datën 7 ka filluar raportimi, për arsye se në datën 7 është hapur aksesin nga KQZ-ja, Bashkisë Tiranë, për të bërë raportim dhe nga kjo datë deri sa sot flasim, besoj janë të gjitha raportimet, kanë ndodhur besoj janë edhe tani që flasim raportohen aktivitetet që bëhen nga Bashkia Tiranë. Por do të thoja që qëllimi i vendimit numër 9, për të përcaktuar detyrimin për të raportuar dhe masa e gjobës ka të bëjë me mundësinë që ti i ke dhënë subjektit për raportim, unë këtë do doja që ju të vlerësonit, pavarësisht diskutimi mbyllet që në fillim që nuk është subjekti dhe kjo nuk diskutohet më nuk po diskutoj vendimin, unë po eci pak më tej, jashtë procedurës për të justifikuar dhe faktin që edhe nëqoftëse do të ishte subjekt, prapë nuk ka qenë ky qëllimi, qëllimi

**Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.16.02.2021

është që nëqoftëse nuk është veprimtari e ndaluar edhe mos raportimi nuk të bën përgjegjës, në momentin kur ti nuk i ke dhënë aksesin për raportim. Po të kishim raste që dhënia e aksesit për raportim, sjellja e subjektit do të ishte neglizhente atëhere mund të provohej këtu që të vinte administrata e KQZ-së dhe të thoshte që Bashkia Tiranë është sjellje e vazhdueshme për mos raportim, pra veprimtaria është ajo thelbësorja e cila e bën detyrim Komisionerin që të vendosi një masë ndaluese që po qe se është veprimtari e ndaluar duhet të eci, nëqoftëse nuk është një veprimtari e ndaluar dhe ti si ke dhënë aksesin për mua nuk mundet të marrësh një masë me gjobë, megjithatë për sa më sipër po ju jap dhe një korrespondencë, ndohet në KQZ e protokolluar që personi përgjegjës nga Bashkia Tiranë i cili është për këtë raportim, ka marrë edhe nga Bashkia praktikën që ka ndjekur vetë Bashkia e Tiranës për sa i përket caktimin e këtij personi përgjegjës, besoj është edhe fakt se cili është personi se ju komunikoni tashmë me të dhe megjithatë nuk mund ti bëjmë gjyqin një personi i cili nuk është kallëzuar, ankimuar, prandaj edhe unë nuk po ia përmend emrin dhe këto po ju a lë si provë se duhej të ishte pjesë, në rastin më të mirë të kallëzuesit duhet ta kishtë përfshirë në kallëzim, se ka përfshirë, e ka quajtur edhe me qëllim se ka përfshirë se normalisht këtu është edhe kërkesa është politike, nuk është juridike se po të ishte juridike do lexonin fare qartë ligjin dhe do të caktonin dhe subjektet që legjitimohen për të bërë kallëzimin. Faleminderit, paraqes dhe këto dy prova dhe një shkresë që i ka ardhur KQZ-së për personin përgjegjës, si dhe praktikën që ka Bashkia e Tiranës në lidhje me caktimin e personit përgjegjës. Faleminderit!

Z.K.Bebe: Më fal, mund të na e sillni pak ta shohim? Mirë faleminderit. Vazhdojmë me parashtrimet e palës tjetër apo do bëjmë pyetje. Vazhdojmë me Lëvizjen Socialiste për Integrim!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, faleminderit z.relator! Atëherë unë po e kap pak tek pjesa e fundit e fjalës së kolegut, tek qëllimshmëria e veprimeve apo e mos veprimeve nga ana jonë për të denoncuar disa persona dhe për të lënë disa të tjerë. Ne e kemi bërë denoncimin sipas të themi një analize të mirëfilltë të bërë nga ana jonë, sipas disa provave të gjetura dhe të çmuara si të tilla edhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Qëllimshmëria nëqoftëse shkojmë dhe shohim është në atë që kolegu sapo disponoi me fjalë këtu përpara këtij Komisioni, e lidh këtë fjalë, këtë pretendim tonin të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, me atë pretendim që ngriti lidhur me mos dhënien e aksesit pikë së pari, para se të parashtroj pretendimet tona lidhur me vendimin dhe me përmbajtjen ankimore të kërkesës së subjektit, lidhur me mos dhënien e aksesit për raportim. Tani, të gjithë ne jemi njohur me vendimin numër 9, të 2020, të Komisionit Rregullator, nëqoftëse shohim nenin 4, pika 5 thotë, subjektet sipas pikës 4, që janë të gjitha subjekte të ekzekutivit pjesën më të madhe, të këtij neni kur e kanë të pamundur teknikisht të aksesojnë në faqe mund të dërgojnë raportime nëpërmjet e-maili zyrtar në adresën raportime.institucione@kqz.gov.al.

Pra, rruga ka qenë e shtruar nëqoftëse kishte patur vullnet, në këtë rast shohim që vullneti ka qenë zero. Jo vetëm që vullneti ka qenë zero, por i kanë bërë dhe karshillik këtij vendimi dhe Komisionit të themi Rregullator, duke dalë dhe publikisht në datën 7 janar duke e sulmuar, duke ushtruar ndikim mbi Komisionin Rregullator dhe mbi KQZ-në në vetvete, duke përbuzur vendimarrjen e KQZ-së dhe ky është një fakt i njohur botërisht tani, se ka dalë në të gjitha mediat. Përsa i përket thelbit për të mos u zgjatur më tej, të nderuar anëtarë të Komisionit, Lëvizja Socialiste për Integrim lidhur me vendimin numër 46 datë 09.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, e gjen totalisht të bazuar në ligj dhe në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

prova, vendimi i ardhur në bazë të një hetimi të plotë të themi dhe të gjithanshëm administrativ. Në thelb vetë zbatimit të ligjit apo të akteve të karakterit hierarkik të marra në shqyrtim nëpërmjet këtij vendimi, ky vendim jep edhe mesazhe që janë shumë të rëndësishme në këtë periudhë që p kalojmë,jep mesazhe qytetarëve që deri diku,po sanksionohet një person që ka shkelur një vendimarrje të një Komisioni të nderuar. Në rastin konkret bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara nga ana e KQZ-së, jemi plotësisht dakod me konkluzionet e këtij të fundit, nëpërmjet të cilave argumentohet se, veprimtaritë e denoncuara nga ID me nr.353,360,362,404,406,580, të zhvilluara nga kryetari i Bashkisë Tiranë, nëpërmjet veprimtarive publike, për të promovuar në kuptim të nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe të neneve 2 gërma b e vendimit numër 9/2020, të Komisionit Rregullator,rezultoi e provuar në fakte dhe në prova që Bashkia Tiranë ka marrë masa aktive për të njoftuar në kohë, nuk ka marrë masa aktive për të njoftuar në kohë KQZ-në me e-mail apo me postë. Pra vetë në vendim pasqyrohet ajo që sapo thashë në fjalën time hapëse, që është neni 4 pika 5, që i jep rrugën për të raportuar subjekteve të përcaktuara në nenin 4. Dorëzimi i dokumentave të pronësisë të shtëpive të rindërtuara, të pohuara nga Bashkia Tiranë në informacionin shpjegues, bashkëlidhur shkresës numër protokolli 2686/1 datë 26.01.2021, përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1,3 shkronja b të vendimit 9/2020 dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë. Inspektimi i shtëpive të rindërtuara dhe promovimi i tyre në këtë rast nuk e ka parë të nevojshme, të arsyeshme Komisioneri për ta futur në pjesën ndaluese të vendimit, pra nuk flitet për ato që sapo kolegu Salianji shpjegoi, që janë pjesë rindërtimi të parashikuara me një vendimarrje të mëparshme e cila nuk hynte në vetvete dhe në kallëzimin tonë, por flitet për veprimtari të tjera të cilësuar më sipër, për të cilat karakteri publik është dhënë nga vetë Kryetari i Bashkisë Tiranë, nëpërmjet njoftimit të mediave

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI*



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021***

audiovizive dhe atyre të shkruara në Shqipëri. Vazhdon Komisioneri, rezulton e provuar se struktura administrative të marrëdhënieve me publikun, komunikimit të Bashkisë Tiranë, kanë njoftuar organet e medias për aktivitete, objekt denoncimi, ose kanë vënë në dispozicion të medias në rrugë elektronike, informacion për veprimtari të ndaluara, pra cili ka qenë qëllimi nëqoftëse jo publiciteti i këtyre veprimtarive, nëqoftëse vetë Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet një urdhri të dhënë, të strukturave të veta i ka thënë dërgoni X informacion tek media për të bërë publicitet dhe kjo nuk hyka sipas z.Salianji, në nenin 2, pika 1, gërma b, të vendimit numër 9/2020, të Komisionit Rregullator, kjo është haptazi e provuar të nderuar anëtarë të Komisionit. Nga përgjigjet e marra, nga mediat, vazhdon Komisioneri në vendimin e vet numër 46, lidhur me raportimin prej tyre të këtyre aktiviteteve, njoftimit për aktivitetet është realizuar përmes zyrës së shtypit të Bashkisë.

***Zbardhi materialin e inçizuar
Romina KOKOSHI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Kështu edhe nëse në momentin real të zhvillimit të aktivitetit nuk ka pasur prezencë asnjë nga, prezent asnjë mediat, dërgimi i materialit për të përgatitur prej vetë Bashkisë Tiranë, përmes zyrës së shtypit të këtij institucioni, secilës prej këtyre mediave vërteton qëllimin dhe informimin e publikut, pra hyn në atë që sapo citova. Për sa më sipër pretendimi i bashkisë dhe ky aktivitet nuk ka patur qëllim informimin e publikut, ashtu sikurse përcaktohet në vendimin nr.9, 2020 të KQZ-së, por transparencën e tij dhe përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në aktin normativ, në këtë rast është shprehur keq, nuk gjendet i bazuar dhe gjendet i pambështetur, në respektim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 , 2020. Pretendimi i Bashkisë Tiranë, dërguar me shkresën 5402/1, datë 05.02.2021, në asnjë rast, këto veprimtari nuk kanë qenë të hapura për publikun apo për mediat nga organizimi, pjesëmarrjen e këtyre të fundit, është i pambështetur në fakte dhe në rrethana, nuk e kanë justifikuar nëpërmjet provueshmërisë së tyre, përkundrazi, kjo gjë deduktohet në mënyre eksplicite që ka ndodhur dhe qëllimi i saj ka qenë publiciteti. Kryetari i Bashkisë Tiranë është përfaqësuesi i një institucioni publik vendor, të cilit Kodi Zgjedhor i ngarkon detyra dhe raportime të posaçme, kështu që kjo optikë e ka bërë atë përgjegjës për raportim dhe për veprimtari të ndaluara për të cilat është sanksionuar. Në rastin e të kallëzuarit nga LSI, pohohet nga vetë subjekti i kallëzuar, dorëzimi i dokumentave të pronësisë të Komisionerit. Ky moment përbën veprimtari të ndaluara pasi veprimtari, veprimtaria ka përmbushur të dyja kushtet kumulative të përcaktuara nga vendimi nr.9, 2020. Shpërndarja e veprimtarive publike dhe certifikatat e pronësisë sipas legjislacionit, karakterit publik informues dhe dorëzimi i certifikatave të pronësisë në vetvete. Atëherë përse i përket pjesës së ankimit të bërë nga zoti Veliaj, së pari në seancën e mëparshme që ka mbajtur ky komision, sipas mendimit tonë duhet të ishin parë

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

pak më mirë, të themi, elementet e formës së ankimit. Kemi cedim të elementeve të formës dhe mungojnë disa nga elementet e formës. Si nga vëmendja e komisionit që kërkesa ankimore e subjektit ankues nuk është në përputhje me elementet e domosdoshme të formës të parashikuara ose të kërkuara nga pika 2, gërma “a” dhe “dh” të vendimit nr.10, të nenit nr.10, të vendimit nr.3, datë 06.11.2020, Komisionit Rregullator për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksione. KAS në përputhje me nenin 17, vendimi 3, datë 06.11.2020 dhe neneve 126 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, duhet të kishte kryer, duhet ta kishte kthyer këtë kërkesë ankimore për plotësim të elementeve të formës. Po të shohim. nuk përmban, të nderuar anëtarë të komisionit, ashtu siç parashikohet dhe në nenin nr.10, pika 2, gërma ”a”, thuhet: Kërkesat ankimore duhet të përmbajnë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme. Të dhënat ledifikuese dhe ankuesit, përfshi adresën postare, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit. Këto gjëra nuk i shohim të jenë në pjesën e kërkesës ankimore. Po ashtu, gërma “dh” e po të njëjtës pikë, thotë që: Burimin e provave duhet të përmbajë, ku janë gjetur provat, cili është burimi i tyre? Si dhe numrin e tyre rendor. Normalisht jemi në një moment procedural të ndryshëm, thjesht, e vura në vëmendje të Komisionit këtë fakt, për të mos cënuar vetëvendimmarrjen totale të themi, të këtij shqyrtimi të ankimit. Lidhur me thelbin e ankimit, si dhe në vëmendje të KAS, si argumentet e parashtruara në ankim, janë një devijim i qellimshëm i situatës së denoncuar, dhe në përmbajtje të tyre nuk provohet e kundërta. Thënë këtë, sqarojmë KAS, se veç pjesës së provuar tashmë të karakterit publik të këtyre aktiviteteve, të cilët veç publicitetit kanë pasur dhe ndalimin e tyre të rreptë për përbërjen e tyre. Ankuesi keqreferon duke u mbështetur në analizën e KAS, të bërë për një çështje pjesërisht analoge, nëpërmjet të cilës ka disponuar në vendimin nr.4, datë 21.01.2020. Vendimi i KAS i referuar në analogji nga ana e

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021**

ankuesit. Për sa i përket pjesës së postimeve të aktiviteteve të ankuesit në faqen e facebook-ut, nuk mund të përdoret si i tillë nga momenti që jemi në dy situata të ndryshme. Pra, në këtë procedurë të shqyrtimit të ankimit, flasim për pakundërshtueshmërinë e karakterit publik të disa denoncimeve dhe aktiviteteve të bëra nga ankuesi dhe ky cilësim vjen nga vetë provat e administruara në dosje, ardhur nga mediat dhe audio-vizive. Këto media janë ftuar nga ankuesi për të pasqyruar nga hapësirat e tyre televizive apo të shkruara promovim, mbështetin aktivitete rreptësisht të ndaluara nga kryetari i bashkisë, duke i dhënë kështu karakterin e padiskutueshëm publik të këtyre eventeve. Një provë tjetër e rëndësishme e raportimit është ajo që unë citova në pjesën hyrëse të fjalës sime, që është: Qëllimshmëria e mosraportimit kur aksesit nëpërmjet vendimit nr.9, 2020 i është dhënë që momentin që faqja, ndërfaqja e raportimeve nuk funksionon në qoftë se kishin pasur qëllim të mirë dhe do donin t'i raportonim mund t'i kishin bërë nëpërmjet email-it zyrtar që është vënë në dispozicion nga ky vendim. Pra, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ky *modus operandi* i të kallëzuarit është bërë në raste të përsëritura duke treguar kështu recitivitetin e tij, dhe mbështetet dhe në deklaratat publike, siç thashë është deklarata e datës 07, është publike, ku ai sulmon vendimmarrjen e KQZ-së. Kjo, domethënë është në mënyrë të hapur një mospërfillje e disa rregullave të qarta për parimin e barazisë së armëve të vendosura në një periudhë të caktuar të cilën po kalojmë në këto momente. Këto janë elemente të mjaftueshme për të marrë në konsideratë nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, lidhur me vendimmarrjen finale të këtij fundit. Për sa më sipër vlerësojmë se vendimi 46, datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është një vendim i mbështetur në ligje dhe në prova. Vlerësojmë se ankimi nuk ka shkaqe të përligjura për t'u pranuar. Në këto kushte mbështetur në nenin 30, pika 1, gërma "b", të

**Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

vendimit nr.3, 2020 të Komisionit Rregullator përfundimisht i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve rrëzimin e kërkesës ankimore të ankuesit, lënien në fuqi të vendimit nr. 46, datë 09.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. K.Bebe: Faleminderit! Prova për pretendime të tjera në këtë fazë, nga palët?

Një zëri: Nuk kemi!

Z. K.Bebe: Dakord, vazhdojmë me pyetjet që ka KAS. Unë kisha vetë një pyetje. U përmend nga avokati i ankuesit që është caktuar një person përgjegjës, si dhe depozituan një dokument. Kjo është korrespondenca, e datës 02, si dhe një kartelë bashkëlidhur. Nëse jeni në gjendje ta, ose është në dijeninë tuaj. Kur është caktuar efektivisht personi përgjegjës? Pra, këtu kemi një formular që drejton, dërgon disa të dhëna, i datës 02.02 dhe kur është caktuar efektivisht, pra është bërë aktiv personi përgjegjës dhe ta individualizoni, kush është personi apo struktura që drejtohet nga personi, nëse është një i tillë?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Faleminderit! Siç dhe parashtrova në ankim, ju këtu jeni *quasi* gjykatë, ju jeni gjykata dhe gjykata gjykon vendimin. Pra, nuk jeni ju që vendosni gjobën ose ju që hetoni. Ju hetoni vendimin që ka marrë kryekomisioneri. Kjo i përket procedurës dhe formës, se unë kam dalë përtej, se unë kam bërë një hetim administrativ sikur po bëhet këtu hetimi, pra nuk është Erion Veliaj, apo kush është?! Këtë se kush është, unë, kjo është një provë që provon që s'është Erion Veliaj, pastaj, është, kush është, kjo i përket një procesi tjetër hetimi administrativ, i cili, në qoftë se ankuesit do bëjnë një kallëzim, mund

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

të hetohet. Megjithatë për të qenë korrekt me ju, unë e kam sjellë si provë shkresën në të cilën përcaktohet personi përgjegjës. Këtu është shkresa e datës 02 shkurt, që është një praktikë me, e protokolluar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por efektivisht KQZ-ja me bashkinë, në datë 07 kanë filluar raportimet, pra personi, i cili pavarësisht se në shkresë ndodhet në datë 07, të datës 2, por personi i cili është caktuar në datë 31 dhjetor. Pra në 07 janar, ka filluar raportimi nga bashkia drejt KQZ-së për veprimtaritë dhe po të shikoni në praktikën që u soll nga Bashkia e Tiranës, në datë 31 dhjetor 2020, në praktikë aty shënohet që, është emri i nënkryetares, e cila ka sigluar dhe është bërë shënimi sipër, të vihet emri im, pra personi i cili sot raporton. Dhe në datë 31 dhjetor 2020, kryetari i bashkisë e ka përcaktuar personin i cili do jetë përgjegjës. Por dhe sikur nuk është personi përgjegjës, e thotë ligji shumë qartë, nuk është kryetari i bashkisë subjekt. Subjekt janë sekretari i përgjithshëm dhe drejtorët. Pra, kjo, ky hetim që ne tashmë po bëjmë, se cili është personi përgjegjës, është për të provuar që s'është tani, drejtor, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, dhe ai është dhe personi përgjegjës që është caktuar nga Bashkia e Tiranës.

Z.I.Rusmali: Juve thatë që, më datë 31 dhjetor, dhjetor ishte? Kryetari i Bashkisë, ka dhënë porosinë që të caktohet personi përgjegjës për komunikimin e, për raportimin. Shkresa nga bashkia ka ardhur në KQZ, më datë 02 shkurt. Ju keni ndonjë shpjegim, për këtë periudhë kaq të gjatë nga vendimi i kryetarit, deri te komunikimi i KQZ-së?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Tani, për sa i përket këtij lloj, po unë, prandaj thashë që në fillim që të bësh një hetim administrativ në lidhje me këtë fakt duhet të jetë vetë personi përgjegjës, i cili është subjekt i kësaj veprimtarie dhe..

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Shpjegim kam. Shpjegimi, shkresën unë e solla tani për shpejtësi, të datës 02, por me KQZ-në, ka nisur komunikimi online, pra ka nisur se kush është personi përgjegjës. Fiktivisht, efektivisht, personi përgjegjës, nuk është ndaluar për të mos bërë ndërhyrje në bazë të shkresës. Pra, në datë 07, pavarësisht se kemi protokolluar një shkresë të datës 02, për shkak të postës së ardhur këtu, kjo nuk e di, etj, etj. Por fiktivisht Bashkia e Tiranës është personi përgjegjës që i është hapur aksesit, me emër, mbiemër, Pra, KQZ-ja , pavarësisht shkresës që ka ardhur më mbrapa, e ka njohur që këtë procedurë administrative duhet ta kryejë ky person, dhe i ka dhënë dhe password-in konkret, pavarësisht shkresës.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: A mund të bëj një replikë në qoftë se më lejon komisioni?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Pra, unë prandaj them që kjo ka nevojë për një hetim administrativ, në qoftë se do ketë lidhje procedim me këtë person.

Z.I.Rusmali: Tani unë kam një pyetje në lidhje me këtë për administratën, Në vendimin e Komisionerit lidhur me këtë çështje, thuhet, që mbasi është marrë shkresa, më datën 02 shkurt, po e perifrazoj se nuk e mbaj mend. Më datë 03 shkurt është dhënë aksesit për personat, se janë disa persona, më datën 03 shkurt është dhënë aksesit, kështu më duket e kam lexuar unë në vendimin e Komisionerit. Tani, pyetja për ju: Është dhënë më datë 07 janar apo më datë 03 shkurt, aksesit?

Z.E.Meta: Në dijeninë time, aksesit është krijuar më datë 07 janar.

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z. K.Belev: Unë kisha dhe një pyetje tjetër, po për avokatin e ankuesin. Eshtë depozituar si provë, bashkëlidhur ankimit, një e-mail i datës 07, ku, sipas kësaj që ne lexojmë, ky është një e-mail i drejtuar nga një adresë e bashkisë. Eshtë drejtuar në adresën raportime.institucione@kqz.gov.al dhe rezulton i kthyer. Pra, çfarë ka dashur të..?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Tani, kjo është paraqitur si provë duke vërtetuar vullnetin që ka pas institucioni për të raportuar. Pra, u tha nga kallëzuesi që përveçse të drejtës për aksesin në sistem, është e drejta për raportim dhe është dhe me e-mail. Dhe me e-mail është provuar nga aksioni i Bashkisë së Tiranës dhe e-mail-i është kthyer mbrapsht. Pra, kjo është, ne këtë kemi dashur të provojmë.

Z. K.Belev: Më fal! Për administratën, për të sqaruar këtë moment. Kjo adresë e e-mail-it si një nga format që parashikohet për raportim. Ka qenë aktive në këtë datë më parë, apo më pas kësaj date? Adresa raportime.institucione

Z. A.Llano: Atëherë për shkak sepse adresa raportime.institucione ishte shumë e gjatë, u vendos nga Komisioneri në bashkëpunim me drejtorin e IT... në rastin konkret që të ndryshohej dhe të bëhej aktiviteti raportime@kqz.gov.al dhe ky ndryshim është bërë brenda asaj dite dhe Komisioneri e ka...

Z. K.Belev: Të cilës ditë më fal?

Z. A.Llano: Të datës 23 dhjetor

Z. K.Belev: A është bërë në atë ditë?

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z. A.Llano: Po, në datën 23 dhjetor është bërë kërkesa mbasdite për ndryshimin e këtij, adresës së e-mail-it dhe është vënë si adresë e-mail-i: raportime@kqz.gov.al dhe Komisioneri këtë si platformë e ka prezantuar dhe në një takim që ka bërë gazetarët, në datën 28 dhjetor, lidhur me prezantimin e faqes së re të KQZ-së. Gjithsesi, në çdo moment, cilado palë e intersuar mund të futej tek faqja e KQZ-së, dhe ishte një buton që është dhe aktualisht, për raportimet, për aktivitetet e ndaluara dhe në çdo moment mund të njihej me adresën. Edhe nëse e kishte, edhe nëse s'e kishte. Pavarësisht vendimit të Komisionit Rregullator.

Z. K.Belev: Më fal, meqenëse Sekretarit të Përgjithshëm, kjo adresë, të paktën në kopjen që kam unë të vendimit nr.9, kjo është adresa që citohet si adresa për komunikim, neni 4, pika 5. Është bërë ky korigjim apo kështu vazhdon të jetë vendimi, në dijenin tuaj? Pra, vendimi rregullator i datës 24, midis të tjerash ka përcaktuar dhe këtë, pra, si një nga mënyrat e komunikimit e-mail zyrtar në këtë adresë, pra ta, kur e kam të pamundur që teknikisht të aksesoj në ndërfaqe, më fal, dhe po këtu do doja të shtoja pyetje. Kur është bërë e aksesueshme ndërfaqja? Në çfarë date, duke pas parasysh kohën e ndërtimit? Në formën që operohet sot, pra...

Z. A.Llano: Ndërfaqja është bërë e aksesueshme që në datë 24 dhjetor 2020. Po! Sepse ishte kërkesë me ngut e Komisionerit dhe prandaj adresa aktivitetekqz.gov.al është hapur më datë 23, që të vihej menjëherë në funksion në momentin që Komisioni Rregullator e prezantoi. Gjithsesi Komisioneri e ka riprezantuar të gjithë, domethënë edhe faqen edhe pjesën e modulit të raportimeve në datën 28 dhjetor, në prani të gjithë gazetarëve.

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z. K.Belev: Pra, nëse e kuptova drejt? Në datën 07 ka qenë aktive adresa e re, e cila pasqyrohet në ndërfaqe, por jo adresa e cituar në modul?

Z. A.Llano: Kjo adresë e-mail-i që është cituar tek Komisioni Regullator ka qenë thjesht për periudhën derisa ndërfaqja të bëhej aktive, por ndërfaqja është bërë aktive më përpara.

Z. K.Belev: Më fal! Kur ka funksionuar? Se ndërfaqja thoni është bërë aktive në datë 24. Kjo adresë kur është bërë aktive adresa raportimeinstitucione apo nuk është funksionale për shkak të adresës që e zëvendëson?

Z. A.Llano: U zëvendësua.

Z. K.Belev: Dakord, nuk kam më pyetje.

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Për sa i përket kësaj, se tani, Bashkia e Tiranës, objekti i funksionimit ka, për punët e saj, dihet se çfarë pune bën Bashkia e Tiranës. Për sa i përket KQZ-së, ka qenë detyrimi i institucionit tuaj të njoftojë Bashkinë e Tiranës në lidhje me këto ndryshime ose gjithë subjektet. Pra, nuk është detyra e institucionit i cili raporton të kontrollojë veprimtarinë e Komisionerit se si ai ndryshon adresat, e-mail-et dhe password-et. Pra, për sa i përket aksesit unë...

Z. K.Belev: Avokat...pretendimet, se unë kisha pyetje për stafin, sqarova në këtë moment, nuk mendoj që...

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: A mund të bëj një ndërhyrje në qoftë se më lejon relatori?

Z.I. Rusmali: Në fund fare do të keni të drejtën e fjalës, dhe ai...

Z. K.Belev: Që mos të bëjmë komente për

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Tani, ne që jemi në aktualitet të pyetjeve, prandaj

Z. K.Belev: Jam dakord! Po nuk do bëjmë komente mbi atë çfarë thotë administrata.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, nuk e kisha mbi atë i nderuar zoti Belev, e kisha lidhur me faktin e mosrektrutimit apo mospërfshirjes të themi, të kryetarit të bashkisë në personin që i ka të ndaluar disa veprimari, ose personi përgjegjës si hallka më e lartë, të themi, administrative e bashkisë. Po të shohim fare mirë nenin 3, pika 2, thotë: Kryeministri, administrata e tij, zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministrat, kryetari i bashkisë, dhe vijon, gjatë periudhës kohore katër mujore para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve e ka të ndaluar të drejtë, të marrë pjesë apo të kontribuojë në çfarëdolloj forme...

Z. K.Belev: Avokat, pa dashur të ndërpres, jemi në fazën që këto gjetje dhe këto qëndrime janë trajtuar në vendimin e Komisionerit...

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Patjetër!

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Z. K.Bebe: Dhe nuk kemi një ankim të tuajin për vendimin e Komisionerit. Pra, natyra e këtyre aktiviteteve nuk është konsideruar e ndaluar, si dhe promovimi për shkak të aktiviteteve që vihen në kuadër të aktit normativ, po e perifrazoj.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ajo është konsideruar e tillë.

Z.K.Bebe: dhe nga ana juaj është kërkuar lënia në fuqi e vendimit duke e konsideruar dhe dispozitivin përkatës. Kështu që mendoj se nuk jemi në fazën që t'i kthehemi mbas, çfarë është pretenduar në ankimin tuaj para KQZ-së.

*Zbardhi materialin e incizuar
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.16.02.2021

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo, thjesht dua të vë...unë jam plotësisht dakord me atë që thatë, por thjesht dua të sjell versionin tonë lidhur me faktin e mospërfilljes që ka pasur në këtë rast. Po të shihni i nderuar zoti Bele. Edhe në rastin e raportimeve në qoftë se shohim te ndërfaqja Bashkia Tiranë nuk raporton sipas parashikimit të nenit 92 dhe sipas parashikimit të nenit 5 të vendimit nr. 9 që thotë: brenda 5 ditëve do të raportohet sot dhe aktiviteti ka për të ndodhur brenda 5 ditëve. Bashkia Tiranë raporton gjithmonë më përpara ka raportuar në datën 6 e ka bërë në datën 8, ka raportuar në datën 1 e ka bërë në datën 4 dhe këto janë gjetur shkelje në vendimin nr.46 dhe kjo është shumë e rëndësishme për t'u marrë parasysh.

Z.E.Çefa: Kisha një pyetje për përfaqësuesin e Kryetarit të Bashkisë. Tek dokumentet e administruara si provë në dosje që titullohen procesverbal paraprak, doja të dija rolin juridik të këtyre dokumenteve ku janë parashikuar? Ekzistenca apo krijimi i këtij dokumenti dhe cili është efekti i parashikuar i këtij dokumenti, qëllimi i tij pse realizohet?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Kjo pyetje ka lidhje me objektin e gjykimit, ka lidhje me veprimtarinë dhe mënyra sesi Bashkia e Tiranës kryen procesin e punës nuk besoj se këtu jemi për të kontrolluar mënyrën e akteve sesi ata bëjnë procesin e rindërtimit, megjithatë unë do të thoja se kjo është një formë, marrja në dorëzim është një formë e përcaktuar në aktet që kanë organet përkatëse për të marrë në dorëzim një objekt të cilët e kryejnë. Është apo jo cfarë vlere ka nuk besoj se ka vlerën e këtij gjykimit. Unë e solla për provë këtë dokument, dokument i cili përmendet si dokument pronësie është ky dokument që ju keni. Pyetja duhet të ishte a është ky dokument pronësie po ose jo. Pastaj se cfarë vlere ka ky dokument



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

unë besoj se ka lidhje me procesin që po kryhet në shtepitë e ndërтуara, pra është një akt i marrjes në dorëzim i personit që hyn në banesë me personat e autorizuar që janë të Bashkisë së Tiranës. Kaq mund të them për atë akt dhe dijenia ime është t'u provojë që nuk është dokument pronësie pastaj po ashtu hajde e shkurtojmë veprimtarinë e Bashkisë së Tiranës në një seancë tjetër dhe do të shikojmë sesi e kanë përfshirë ata këtë dokument në procesin e rindërtimit.

Faleminderit!

Z.E.Çefa: Faleminderit avokat por unë prapë nuk jam i qartë dhe një herë jam duke vlerësuar provat që i keni parashtruar ju, ju më thoni se nuk është dokument pronësie. Atëherë unë po ju pyes cfarë dokumenti është ky?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Besoj se ka të gjithë ekstrabilitetet, mund ta lexoni në dokument dhe i firmosur i vulosur nga personat përgjegjës.

Z.L.Braho: Për përfaqësuesin e Kryetarit e Bashkisë, edhe unë jam dakord që ndoshta në pamjen e parë nuk janë dokumente që bëjnë kalimin e pronësisë. Këtu në fakt e rëndësishme në zbatim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor është pjesa sesi publikohen këto dhe vetë provat e paraqitura nga Kryetari i Bashkisë dhe nga mediat, në disa raste citohet: i referohem informacionit sqarues që i është bashkëlidhur shkresës 2681\1, të datës 21.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë. Te pika 2 thuhet: info Kryetari i Bashkisëc Tiranë zoti Erjon Veliaj, Ministri i Shtetit për Rindërtim zoti Arben Ahmetaj dhe prefekti i Tiranës zoti Toni Gogu dorëzuan dokumentat e pronësisë e banesave të rindërtuara. Më tej pikën 4 Dashamir Paci, Ylli Troksi dhe Muhamet Deliu morrën në duar dokumentat e pronësisë së banesës

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.16.02.2021

së sapo rindërtuar nga Kryetari i Bashkisë Erjon Veliaj. Pika 6 dy familje në Zall Herr banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti kanë marrë celsat e shtëpive të reja. Pika 7 pas tërmetit shkatërrues një viti më parë familjet e Hidër Danit dhe Dan Danit nga fshati Cërkëz Zall Herrit morën pronësinë e banesës së rindërtuar. Pika nr. 8, familja...Pika nr.9 Hekuran Balla, Shyqyri Shabani dhe Alfred Tresa nga fshati Balshaban morën celsat e banesave të reja nga Kreu i Bashkisë Tiranë Erjon Veliaj. Pika nr. 10 Kryebashkiaku vizitoi familjet e Ramazan Memës dhe Mariglen Ballës në Farkë, të cilët hyjnë në shtëpitë e reja të sapo rindërtuara. Po ashtu në komunikimet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur me mediat. Gazeta Panorama thotë: në publikimin e aktiviteteve të Kryetarit të Bashkisë Tiranë zoti Erjon Veliaj është bazuar në njoftimet zyrtare të zyrës së komunikimit të Bashkisë Tiranë si dhe në email i dërguar në adresën tonë. Ndër të tjera në njoftimet që vijnë nga Bashkia Tiranë në email do të gjeni njoftimin e kryetarit Veliaj, i cili dha celsat e tri shtëpive të reja në Baldushk. Bashkëngjitur do të gjeni njoftimin e Kryetarit Veliaj, i cili së bashku me Ministrin Ahmetaj i dorëzuan dokumentat e pronësisë disa familjeve që u rindërtuan shtëpitë në njësinë Pezë. Pra, janë dhe njoftimet po ashtu i referohet gjithmonë si dokumenta pronësie dhe vetë Kryetari i Bashkisë i referohet si dokument pronësie në shkresën që i ka dërguar KQZ-së ju cituat se është lapsus. Pa i hyrë pjesës se a janë dokumente pronësie apo jo por në qasjen tuaj, a është tentuar që këto dukumenta publikohen si dokumenta pronësie në facebook apo në media?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Në fakt në kuptim të ligjit 111 2018 për Kadastrën flitet fare qartë se cilat janë dokumentat e pronësisë dhe janë të cituara kur dokum,netat e pronësisë janë certifikatat, vërtetimet ekstraktet e kartelës...., hartat kasadale dhe hartat e parashikuara në këtë ligj. Atë se çfarë kërkon vet

24

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

vendimi nr.9 i vitit 2020 të cilët janë ndaluese për t'u shpërndarë, besoj këto që ju përmendët janë në formë që kërkon ligji për t'u trajtuar si akte pronësie.

Z.K.Beles: Keni pyetje të tjera?

Z.L.Braho: Kisha dhe një pyetje tjetër në lidhje me një informacion, po ashtu të shpërndarë nga Bashkia Tiranë të datës 7 Janar 2021, këtë e lidh dhe me pikën 2 të nenit 10 të vendimit të Komisionit Rregullator ku ndër të tjera sanksionon dhe rastet kur është Kryetari i Bashkisë apo drejtuesit e institucioneve që pengojnë në raportim. Ndër të tjera për të mos lexuar të gjithë informacionin e Drejtorisë së Informacionit ka komente të tipit që KQZ-ja nuk mund të jetë tryezë analistësh, por duhet t'i bëjë të qarta rregullat fakti që dikush para nesh kur ishte Kryetar Bashkie fjeti gjumë, pra janë një sërë citimesh që flasin në lidhje me raportin mes Bashkisë Tiranë apo Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ju duket ju në kuptimin që i jepni ju si përfaqësues i Kryetarit të Bashkisë. Nuk ka korotacion të tillë që pengon le të themi atë që kishte përcaktuar si raportues për të raportuar informacionet ose më saktë aktivitetet e kryera nga Bashkia Tiranë në lidhje me këtë vendimmarrje të Komisionit Rregullator?

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Ne këtu në fakt po i bëjmë gjyqin Kryetarit të Bashkisë Erjon Veliaj në lidhje me detyrat dhe funksionin që ka pasur ai në lidhje me këtë proces. Sesa Bashkia e Tiranës dhe Kryetari i Bashkisë sesi janë raportet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ju jeni pjesë e këtij institucioni dhe mund ta vërtetoni ndërmjet administratës që nga data 7 dhe deri sot ku flasim raporti i raportimit është i drejtë janë raportuar të gjitha aktivitetet? Këtu shikohet qëllimi që ka Kryetari i Bashkisë në lidhje me detyrimet ligjore për këtë fakt. Ne kemi

25

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

vërtetuar që nga data 7 janë raportuar të gjitha veprimtaritë dhe nuk ka asnjë neglizhencë në lidhje me veprimtaritë dhe me detyrimet që përcakton ligji për sa i përket këtij problemi, pjesa tjetër nuk ka të bëjë me procesin. Sesa Kryetari i Bashkisë e njeh ligjin dhe e zbaton këtë vetë administrata mund të na thotë a ka kallzim tjetër nga subjekti pas kësaj date? Se do të kishin të paktën një kallëzim në datën 15 meqë ishin *arroganca* që po thuhet në datën 17 në datën 20, në momentin që i ke dhënë aksesin ka shkuar çdo gjë mirë dhe çdo gjë drejt. Faleminderit!

Z.K.Bele: Nëse nuk keni pyetje, ftojme palët për të vazhduar me pretendimet përfundimtare.

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Për sa i përket shqyrtimit administrativ që ju po bëni, ju bëj me dije sic e thashë dhe në fillim ne sot, ju gjykata se jeni gjykatë në këtë rast, po gjykoni vendimin e Komisionerit, i cili ka ardhur si pasojë e kallzimit të bërë nga subjekti LSI. Sa i përket këtij shqyrtimi administrativ unë do të kërkoja nga ana juaj që ta shqyrtoni drejt në bazë të ligjit dhe duke mos dalë jashtë kufijve atë çfarë parashikon vendimi se gjatë shqyrtimit ndërmjet pyetjeve arrita të kuptoja që këtu po i bëhet gjyqi dhe një të kallzuarit tjetër i cili nuk është pjesë e këtij hetimit administrativ. Pavarësisht se ju e njihni mjaft ligjin në Kodin e Procedurës Administrative që një proces administrativ i bëhet në lidhje me kërkusin dhe kundra kërkusit ose ankuesi kundra një subjekti të caktuar. Dhe ju si gjykatë keni detyrimin që të verifikoni në këtë rast janë apo jo subjekte? Ne e paraqitëm para jush në bazë të ligjit dhe vendimit nr.9 2020, Kryetari i Bashkisë nuk futet te subjektet të cilat është raportues dhe që në atë moment gjoba për këtë shkak duhet të pushojë jo duhet të hiqet po duhet të pushojë se nuk është subjekti. Për sa i

26

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

përket gjobës së dytë në lidhje me veprimtaritë e ndaluara do të shtoja vetëm një fakt tjetër që lashë pa përmendur në fillim që ka të bëjë me raportimi që është pjesë publike që kanë ndodhur që këto fakte janë para publiku. Unë do të thoja që Bashkia e Tiranës nuk kufizohet vetëm nga vendimi nr.9 i vitit 2020, por ka së pari Akti Normativ i vitit 2019 që e detyron Bashkinë e Tiranës që cdo veprimtari e ka me detyrim që lidhet me procesin e rindërtimit ajo duhet ta bëjë publike për shkak të transparencës dhe fondeve që shpenzon në lidhje me këto veprimtari është detyrim ligjor, pra këtu kemi aktin normativ dhe vendimin e KQZ-së konform me njëra tjetrën. Pra dhe sikur Akti Normativ është mbi vendimin e këtij institucioni. Është bërë detyrimi për njoftim për këtë shkak, për shkak të transparencës dhe jo për atë çfarë thuhet në ankim. Për sa i përket problemeve formale besoj që ngriti ankuesi, kërkesa është shumë mirë, forma nuk besoj se LSI-ja nuk e ka numrin e Erjon Veliaj që të jetë shkak ky për mospranimin e ankimit që nuk është vënë në ankim, besoj se numrin nuk e ka ndryshuar ai numër është. Kërkoj për pikën e parë: Rrëzimin e Ankimit dhe shfuqëzimin e gjobës dhe për pikën e dytë: Pushimin për arsye se nuk është subjekti që duhet të gjykojmë nga Komisioneri në lidhje me këtë shkelje. Faleminderit!

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Ne jemi të bindur se ky komision nuk do të influencohet nga ajo deklaratë publike që sapo citoi anëtari i komisionit zoti Braho. Ne jemi të bindur se ky komision do të marrë në shqyrtim të gjitha rrethanat, provat të vëna në dispozicion nga palët. Po ashtu sic jemi të bindur se ky komision njih mirë detyrën e vet dhe njih mirë aktin e komisionerit vendimin e komisionerit nr.9 2020. Njih mirë nenin 3 pikën 2 që unë citova që e përfshin totalisht Kryetarin e Bashkisë si person, i cili i ka të ndaluar disa veprimtari të parashikuara në pikën 1, 1\3 dhe i ka të detyruara disa veprimtari të tjera për t'u

27

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

raportuar apo për t'u promovuar të parashikuar në pikën 1\1. Për të mos u zgjatur më tej lidhur për sa u parashtrua në këtë seancë, i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbështetje të nenit 30 pika 1, germa b vendimit nr.3 të vitit 2020 të vendosë:

- 1: Rrëzimin e kërkesës ankimore të ankuesit.
- 2: Lënien në fuqi të vendimit nr.46 datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z.K.Bebe: Ju faleminderit! KAS do të tërhiqet për të marrë një vendim dhe do të mbledhemi sërish në orën 15:30.

Rifillon mbledhja e Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve

Ora 15:30

Z.K.Bebe: Në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 46, dt. 09.02.2018, KAS bazuar në analizën e provave e fakteve të administruara, me shumicë të anëtarëve vendosi ndryshimin objekt ankimi konkretisht për pikën 1: duke konstatuar se Kryetari i Bashkisë nuk është personi përgjegjës për raportimin, sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor si edhe duke konstatuar se caktimi i personit përgjegjës është bërë në datën 07 Janar 2021 dhe raportimet në vijim përsa i përket objekt ankimit janë vlerësuar në përputhje me ligjin dhe në këto rrethana nuk kemi përgjegjësi administrative të personit të kallëzuar vendosi:

- Shfuqëzimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj Erjon Veliaj Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 35 mijë lekë për shkelje të nenit 92 pika 1, 2, 3 të ligjit 1019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

28

**Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.16.02.2021*

Për pikën 2, duke konstatuar se gjatë veprimtarive të denoncuara nuk janë shpërndarë leje apo certifikata pronësie. Sipas përcaktimit të ligjit nr.111 të vitit 2018 për Kadastrën, vendosi:

- Shfuqëzimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj Erjon Veliaj Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 40 mijë lekë, për shkelje të nenit 3 pika 1, 2, 3 të vendimit nr.9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative në Shkallën e Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Vendimi nr.6

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*

